



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVË

Numri i lëndës: 2020:124385

Datë: 05.12.2023

Numri i dokumentit: 05016564

C.nr. 4286/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. L nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S. B avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria për Shëndetësi me seli në Fushë Kosovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Hasnime Qyqalla, me objekt kontesti kompensimin e një page jubilarë, vlera e objektit të kontestit 655.48 euro, në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 21.11.2023 në prani të përfaqësuesve sipas autorizimit të palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datë 05.12.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit A. L nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria për Shëndetësi që në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës, paditësit t’ia kompensoj një pagë në vlerë prej 655.48 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm;
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A. L nga Prishtina, përmes të autorizuarit të tij, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datë 30.09.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria për Shëndetësi, me seli në Fushë Kosovë, për kompensimin e një page jubilarë për 10 vite të përvojës së punës. Paditësi, në padi dhe në seancë gjyqësore ndër të tjera ka theksuar se është në marrëdhënie të rregullt pune te e paditura dhe atë në pozitën e punës doktor i stomatologjisë, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Fatmir Krasniqi” në, e që vazhdon edhe sot. Ka theksuar se në përgjithësi ka 15 vite, 7 muaj dhe 2 ditë përvojë pune, e që si rrjedhojë e saj e paditura është e obliguar t’ia paguajnë paditësit shumë prej 655.48 euro, në emër të një page jubilarë. Në lidhje me bazën juridike të kërkesëpadiës, paditësi kërkesën e tillë e mbështetë në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë.

Paditësi në fjalën përfundimtare, ka qëndruar në tërësi pranë kërkesë padisë, duke kërkuara nga gjykata aprovimin në tërësi të padisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën e përgjithshme prej 364.00 euro dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro; për përpilimin e precizimit të padisë shumën prej 104.00 euro; për përfaqësim për një seancë gjyqësore shumën prej 135.00 euro; dhe për taksë gjyqësore për padi shumën prej 21.00 euro.

E paditura komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria për Shëndetësi, me seli në Fushë Kosovë, me datë 26.09.2023, ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, por që para gjykatës nuk ka parashtruar përgjigje në padinë e paditësit.

E paditura, në seancë gjyqësore dhe fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar, e duke theksuar se e paditura nuk e ka pasur obligim që paditësit t'ia kompensoj një pagën jubilarë për arsye se paditësi vitin e parë jubilar e ka arritur në vitin 2015, në kohën kur Kontrata Kolektive nuk ka qenë në fuqi, e si rrjedhojë e saj i njëjti nuk mund të përfitoj nga kjo kontratë.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: Kontratën e punës e lidhur në mes të ndërgjyqësve me numër protokolli 743, e datës 18.12.2013; Vërtetimin me numër 697 të datës 17.09.2020 i lëshuar nga e paditura; si dhe Kopjen e listës së pagave për muajin gusht për paditësin.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e gjetur padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Kështu, në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi ka qenë dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie pune tek e paditura Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Fatmir Krasniqi” në, i punësuar që nga viti 2005. Nga kontrata e punës e lidhur mes ndërgjyqësve e datës 18.12.2013, si dhe vërtetimi i lëshuar nga e paditura, i datës 17.09.2020 para gjykatës u vërtetua se paditësi ishte në raport juridik me të paditurën. Së këndejmi, raporti kontraktual juridik në mes të ndërgjyqësve për periudhën nga viti 2005 e edhe aktualisht, nuk paraqiti çështje për diskutim në mes ndërgjyqësve.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse është paraqitur fakti se a i takon paditësit e drejta e kompensimit të pagave jubilarë në vlerën e një page mujore ashtu siç pretendon paditësi, apo kjo e drejtë nuk i takon nga shkaqet e argumentuara nga ana e të paditurës e që ishin: fakti se paditësi është në marrëdhënie pune nga viti 2005, e që 10 vite përvojë pune i ka mbushur në vitin 2015, pra para hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive Sektoriale.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë nuk mund të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë (KKSSH), e miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 12.06.2018 (e cila është e zbatueshme prej datës 11.06.2018 e deri me 10.06.2021). Kjo për faktin se mungon baza juridike për njohjen e shpërblimit jubilar të kërkuar me kërkesëpadinë e paditësit, ngase e drejta për të kërkuar kompensimin e pagave jubilarë fitohet vetëm nëse kushti për të fituar këtë të drejtë arrihet në periudhën sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë.

Gjykata me rastin e vendosjes mori për bazë edhe standardin e të drejtës civile i cili përcakton veprimin e ligjit material në kohën dhe territorin e caktuar, e nga kjo erdhi në përfundim se për të përfituar shpërblimin jubilar nga KKSSH, viti jubilar i punësimit (për paditësin viti jubilar i punësimit është viti 2015) duhet të arrihet në kohën kur kjo kontratë kolektive ka qenë në fuqi. Duke marrë për bazë faktin se kjo kontratë ka qenë në fuqi prej datës 11.06.2018 e deri me datë 10.06.2021, ndërsa paditësi 10 vite përvojë pune i ka arritur në vitin 2015, gjykata erdhi në përfundim se përkundër faktit se paditësi ka mbi 10 vite përvojë pune të pandërprerë tek e paditura, një e drejtë e tillë nuk mund t'i njihet paditësit, për arsye se në kohën kur paditësi ka arritur kohën e shpërblimit jubilar, kjo kontratë kolektive nuk ka qenë në fuqi.

Ky qëndrim i gjykatës është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme lidhur me ligjin e aplikueshëm, marrëveshja e përgjithshme kolektive dhe kontratat sektoriale, si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar.

Vendimin në lidhje me shpenzimet e procedurës, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori në përputhje me nenin 450 të LPK-së, ashtu që vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga sa u tha më lartë, në përputhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.4286/20, datë 05.12.2023

Gjyqtarja  
Qëndresa Beqiri Murati

*UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.*